

KONTRATA SOCIALE 2023 – 2027

BASHKIA TIRANË

Detajimi i prioriteteve

Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Tiranës

- Afishimi i stacioneve dhe orareve në vendqëndrimet e autobusëve në të gjitha njësitë administrative të Tiranës.
- Adresimi i problemit të mbingarkesës dhe rritja e shpeshtësisë së lëvizjes së autobusëve të linjave: Qyteti Studenti (autobusët janë të vegjël dhe mbingarkohen); Depo e Ujit – Qendër; Unaza; Porcelani; Kamza dhe Alliasi (nuk ka lehtësira për personat me aftësi të kufizuar); Linja e Kristalit dhe ajo e Yzberishtit.
- Shtimi i fashave orare të linjave të Farkës, Dajtit dhe Baldushkut ku autobusët vijnë çdo 45, 50 ose 60 minuta.

Garantimi dhe aksesimi në ujë të pijshëm dhe të konsumueshëm

Uji i Pijshëm

- Kërkohej furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë në njësitë administrative nr. 1, 2, 3 (përveç lagjes “Sadik Petrela” ku ka ujë 24 orë), 4, 5, ku uji vjen vetëm 3 herë në ditë dhe nuk është i konsumueshëm.
- Njësia administrative nr. 7: Tek rruga “Muhamet Gjollësia”, nuk arrin mjaftueshëm ujë në katet e larta. Uji vjen 2 herë në ditë dhe nuk është i konsumueshëm.
- Njësia administrative nr. 8: Uji vjen 3 herë në ditë ndërsa tek rruga “Gjon Buzuku” zgjatja e furnizimit me ujë është maksimumi vetëm 20 minuta çdo herë. Nuk është i konsumueshëm.
- Njësia administrative Farkë: Kërkohej uji i konsumueshëm 24 orë në të gjithë njësinë, përveç Lendrës ku uji është i pijshëm.
- Njësia administrative Dajt: Kërkohej uji i konsumueshëm 24 orë në Priskë. Gjithashtu nevojitet më shumë rregullsi në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit.
- Njësia administrative Baldushk: Mungon dhe kërkohej vendosja e rrjetit ujësjellës në të gjitha fshatrat përveç qendrës së njësisë (Baldushkut).

Kanalizimet

Sistemi i kanalizimeve ka nevojë për ndërhyrje në:

- Njësia administrative nr. 2: Tek rruga “Kadri Kërçiku” (te fushat e zeza) ku problemi ka 3 vite që ekziston. Gjithashtu, në zonën në të dy anët e Depos së Ujit, që lidhet me rrugën “Gramoz Pashko”.
- Njësia administrative nr. 3: Në rrugën “Gjolek Kokona” (tek vendstrehimet); Nevojitet restaurimi i kanalizimeve të ujërave të shiut.
- Njësia administrative nr. 5: Në rrugën “Isuf Elezi”, përballë shkollës “Arkos”, në vazhdimësi bllokohen pusetat. Tek rruga “Andon Zako Çajupi”, ndërtesat 14, 15, prapa

supermarket Xhangollit, sheshi para pallatit është i pashtuar dhe ka probleme me kanalizimet.

- Njësia administrative nr. 8: Rruga “5 Maji” tek shkolla “Tirana Jonë”.
- Njësia administrative Farkë: Duhet rregulluar kanalizimet dhe tubacionet në rrugët dytësore: Rruga “e Varrezave”, rruga “e Zojnave” dhe rruga “e Vreshnjave”.
- Njësia administrative Baldushk: Në Fushëz, ku lagja është e bllokuar, si dhe në Mustafakoçaj ku kanalizimet nuk janë të sistemuara dhe krijojnë burime infeksioni.

Infrastruktura rrugore: Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve dhe sinjalizimit rrugor.

- **Njësia administrative nr. 1:** Ndërhijrje në rrugët: “Hasan Prishtina” përballë pularisë; “Shaban Baxhaku” pranë arkivit popullor; “Gjin Marku” tek Uzina e Traktorit; segmenti nga rruga “Asdreni” tek rruga “Hodo Beg”; “Dhimitër Kamarda”.
- **Njësia administrative nr. 2:** Ndërhijrje në rrugët: “Shyqyri Ishmi” (prapa zyrave të njësive administrative); Rrugët e ndërmjetme nga rruga “Zonja Çurre” te shkolla “Mihal Grameno”; rivitalizimi i trotuarit në rrugën “Sali Nivica”; “Petro Nini Luarasi” tek Tregu Elektrik; “Fuat Toptani”; Rruga Budi.
- **Njësia administrative nr. 3:** Ndërhijrje në rrugët: “Kongresi i Manastirit”; “Skënder Kurti” e pashtuar pas punimeve për kanalizimet; Rruga nga shkolla “Niket Dardani” deri te rruga “Arkitekt Sinani”; Nevojitet rikualifikim i rrugës “Hoxha Tahsim” si dhe stola betoni për moshën e tretë.
- **Njësia administrative nr. 5:** Ndërhijrje në rrugën “Nikolla Tupe”
- **Njësia administrative nr. 7:** Shtrimi i segmentit të rrugës “Naim Frashëri” nga blloku i ambasadave deri te rruga “e Kavajës”.
- **Njësia administrative nr. 8:** Ndërhijrje në infrastrukturë si vijon: Mungojnë vendparkimet në rrugën “Gjon Buzuku” (te pallati 100); Që nga 9-katëshet dhe deri sipër Selvisë si edhe Rruga “5 Maji”, nuk ka trotuare të mirëfillta dhe qytetarët (sidomos nënat me karroca fëmijësh dhe personat me aftësi të kufizuar) hasin vështirësi në lëvizje.
- **Njësia administrative Farkë:** Ndërhijrje si vijon: Nga Farka e Vogël deri në Sauk, një segment (lagje e vjetër) kërkon mirëmbajtje në asfaltim. Rruga jug-Bathore është e parregulluar totalisht.
- **Njësia administrative Dajt:** Ndërhijrje si vijon: Rrugët te Fresku, Thesari, Lanabregas, Priskë, Tufinë; Fshatrat Murth, Selbë dhe Darshen janë komplet të izoluar dhe kanë nevojë për ndërhijrje në infrastrukturën rrugore;
- **Njësia administrative Baldushk:** Fshatrat Vrap, Vesqi, Parret dhe Kakunj nuk kanë rrugë dhe janë të izoluar.

Shkollat: Rikonstruksioni apo/dhe ngritja e shkollave në zonat me mbipopullim ku numri i fëmijëve për klasë është shumë i lartë.

- Duhet shtuar shkollat në njësitet administrative 1, 2 dhe 4 pasi ka mbingarkesë me nxënës në shkollat ekzistuese.
- Qytetarët kërkojnë ofrimin e shërbimit “*after school*” në më shumë shkolla të Tiranës. Aktualisht ky shërbim ofrohet në vetëm 4 shkolla pilot.

- Në njësinë administrative nr. 7 ka nevojë për ndezjen e kaldajave gjatë dimrit, sepse edhe pse sistemi i ngrohjes është instaluar ato nuk ndizen ose ndizen shumë pak.
- Zona e Liqenit të thatë ka nevojë për shkollë 9-vjeçare, si zonë në zhvillim.
- Në njësinë administrative Farkë, shkolla Farka e Madhe është e bashkuar (ka edhe 9-vjeçaren, edhe gjimnazin në të njëjtin vend) dhe funksionon me turne. Qytetarët kërkojnë ndarjen e dy sistemeve në shkolla të veçuara. Gjithashtu kërkojnë që në hapësirat e shkollës të ngrihet një park lojërash dhe palestër për zhvillimin e orës së fizikulturës.
- Kërkohet ndërtimi i një shkolle të re në Mustafakoçaj të Baldushkut, pasi shkolla ekzistuese ka kushte shumë të këqija, ose rikonstruktimi i aktuales.

Kopshtet dhe Çerdhet: Rikonstruksioni apo/dhe ngritja e shkollave në zonat me mbipopullim ku numri i fëmijëve për grup është shumë i lartë. Vëmendje të veçantë njësive administrative rurale.

- Duhet shtuar kopshtet për shkak të mbingarkesës në njësitë administrative nr. 1 dhe nr. 7. Gjithashtu në njësinë 5 kërkohet shtimi i stafit dhe zgjerimi i ambienteve në kopshte.
- Në Farkë kërkohet ndërtimi i një çerdheje e cila mungon, dhe kërkohet zgjatja e orarit të kopshtit të fëmijëve deri në orën 16:30 duke përfshirë edhe drekën.
- Kërkohet një kopsht me drekë në Dajt, si dhe çerdhe dhe kopsht në fshatin Mustafakoçaj të Baldushkut.
- Në njësinë 4, te zona 3700 duke shkuar për në Tufinë, qytetarët kërkojnë ndërtimin e një kopshti për fëmijët.

Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor: Programe për gratë dhe të rinjtë për fuqizimin ekonomik

- Më shumë shërbime dhe programe për të rinjtë me qëllim që të mos largohen nga vendi. Gjithashtu duhet rritur informimi i qytetarëve për programet ekzistuese.
- Programet ekzistuese për nxitjen e punësimit dhe biznesit, sipas qytetarëve janë të pamjaftueshme. Kërkohet shtimi i këtyre programeve dhe rritja e numrit të përfituesve.
- Duhet të adresohet problemi i mungesës së mundësive të punësimit për të kthyerit nga emigracioni.
- Duhet analizuar më mirë ofertat e punës për gratë e regjistruara në zyrat e punës, me adresën se ku ofrohet puna, sepse largësia e madhe i pengon ato të pranojnë punësimin.

Shërbimet Sociale për grupet në nevojë: Fokus të veçantë të mbijetuarat e dhunës në familje, moshës së tretë, personave me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë në nevojë.

- Në njësitë administrative nr. 2, 3, 4, 5 dhe Farkë kërkohet shtimi i qendrave komunitare që ofrojnë shërbime për grupet në nevojë në mënyrë që të eliminohet problemi i largësisë së vendbanimeve të qytetarëve nga qendrat ekzistuese.
- Kërkohet adresimi i problemit të ofrimit të terapisë për fëmijët me aftësi të kufizuara nga moshë 12 deri në 18 vjeç, pasi aktualisht terapia ofrohet vetëm deri në moshën 12 vjeç.
- Kërkohet ngritja e një qendre rezidenciale për gratë e dhunuara që nuk kanë shtëpi.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë;
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
Qendra Rinore Vlorë,
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
Epoka e Re, Fier;
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;

Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
Qendra Rinore për Progres, Kukës,
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim,
Pogradec;
Gruaja në Zhvillim, Korçë;
Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
Tjetër Vizion, Elbasan